



Njoftim për shtyp 15 Korrik 2019

15 July, 2019 by **KLGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot më datë 15.07.2019, Këshilli i Lartë Gjqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në të cilën miratoi verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin si gjyqtar, të 10 (dhjetë) kandidatëve diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës, për profilin gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2017-2018.

Procedura e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore u bë në përputhje me vendimin Nr. 75, datë 23.05.2019, të Këshillit të Lartë Gjqësor, për rekrutimin si gjyqtar të kandidatëve përkatësisht: **znj. Suela Dashi, znj. Afërdita Caco, znj. Merita Karaj, z. Ardit Kuka, znj. Amarilda Sulaj, z. Ervin Sulaj, z. Olti Skrame, znj. Enkeleda Dalipi, znj. Lorena Çabej dhe znj. Suela Xhani.**

Vendim i sotëm i KLGJ-së merr një rëndësi të veçantë, nëse mbahen parasysh efektet dhe mungesat e krijuara nga procesi i rivlerësimit kalimtar, nevojat e sistemit për kontributin profesional të këtyre magjistratëve të rinj për t'u ofruar qytetarëve shqiptar një drejtësi siç e meritojnë dhe pa vonesa. Ai hap rrugën për emërimin në detyrë të këtyre magjistratëve të rinj dhe përpiqet të plotësojë nevojat e sistemit me profesionistë të kualifikuar dhe me integritet.